

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË WIZZ DISCOUNT CLUB

### 1. INTERPRETIMI

- 1.1. Kushtet dhe shprehjet e përkufizuara në Kushtet e përgjithshme të transportit të Wizz Air do të kenë të njëjtin kuptim kur përdoren në këto Kushte të përgjithshme përveçse kur përcaktohet ndryshe më poshtë ose kur e kërkon ndryshe konteksti.
- 1.2. Përkufizimet

**Kushtet e përgjithshme të transportit** janë kushtet e përgjithshme të transportit të Wizz Air siç publikohen në faqen e internetit dhe siç ndryshohen herë pas here nga Wizz Air.

**Anëtar** ose **ju** është personi i emërtuar si anëtar i Wizz Discount Club gjatë aplikimit për anëtarësim në Club.

**Wizz Discount Club** ose **Club** është hartimi i ofertës sonë speciale, i cili zbatohet sipas dhe në përputhje me kushtet e përgjithshme aktuale dhe u jep të drejtën anëtarëve për përfitime të caktuara siç përcaktohet në këtë dokument.

**Numri i llogarisë Wizz** është numri 10-shifror i identifikimit i krijuar nga sistemi i rezervimit pas përfundimit të regjistrimit në Wizz Air.

**Wizz Air** ose **ne** është subjekti Wizz Air (Wizz Air Hungary Ltd ose Wizz Air UK Ltd ose çdo subjekt tjetër Wizz Air) që operon fluturimin ku ju keni blerë anëtarësimin në WIZZ Discount Club dhe i cili lëshon faturën për blerjen në WIZZ Discount Club.

### 2. KUALIFIKIMI DHE REGJISTRIMI

- 2.1. Mund të bëheni pjesë e Wizz Discount Club:
  - në internet përmes procesit të rezervimit duke blerë anëtarësimin në Club dhe duke paguar tarifën vjetore të anëtarësimit kur rezervoni fluturimin;
  - përmes qendrës sonë telefonike kur kryeni një rezervim dhe blini anëtarësimin përmes qendrës telefonike, si dhe kur paguani tarifën vjetore të anëtarësimit në Club.
- 2.2. Tarifa e anëtarësimit do t'ju njoftohet në kohën e blerjes.
- 2.3. Ne ruajmë të drejtën t'ia refuzojmë anëtarësimin kujtdo dhe, në rastin e shkeljes së këtyre kushteve të përgjithshme nga anëtari, ta përfundojmë anëtarësimin në çdo moment.

### 3. PAGESA E TARIFËS SË ANËTARËSIMIT

- 3.1. Kur të blini anëtarësimin në Club, ju do të paguani tarifën vjetore të anëtarësimit. PAGESA E TARIFËS VJETORE mund të kryhet me kartë bankare dhe/ose kredite WIZZ.

### 4. PËRFITIMET NGA ANËTARËSIMI

- 4.1. Anëtarësimi në Wizz Discount Club u jep të drejtën anëtarëve për tarifa fluturimi speciale Club, që nuk janë të disponueshme për jo-anëtarët, si dhe përfitime të tjera që ju njoftohen në momentin e blerjes së anëtarësimit.
- 4.2. Anëtarësimi në Club nuk garanton disponueshmërinë e tarifave speciale të Club në të gjitha itineraret dhe në çdo kohë (p.sh.: itineraret brenda vendit, fluturimet e operuara për ngjarje të veçanta, etj.).
- 4.3. Përfitimet mund të ndryshohen pa njoftim paraprak ndaj jush.

- 4.4. Ne rezervojmë të drejtën të ndryshojmë, përmirësojmë ose reduktojmë përfitimet në çdo kohë. Ne gjithashtu mund të vendosim kërkesa ose kufizime mbi përdorimin e përfitimeve. Informacioni aktual për përfitimet mund të gjendet në [wizzair.com](http://wizzair.com) te Shërbimet e WIZZ. Nëse nuk pranoni ndonjë ndryshim, mund ta përfundoni anëtarësimin duke na shkruar. Në këtë rast, zbatohet klauzola 6.5 e kushteve të përgjithshme aktuale.
- 4.5. Përfitimet janë të vlefshme për anëtarët e WIZZ Discount Club dhe pasagjerë të tjerë të përfshirë në të njëjtin rezervim, vetëm nëse numri i pasagjerëve në rezervim nuk e tejkalon numrin e përfituesve të llojit të anëtarësimit të WIZZ Discount Club të blerë.
- 4.6. Përfitimet nuk janë të disponueshme për pasagjerin (pasagjerët) që rezervohen nga ju veçmas.
- 4.7. Përfitimet nuk do t'u rimbursohen anëtarëve për rezervimet e kryera përpara blerjes së anëtarësimit.
- 4.8. Anëtarësimi në Club nuk është i transferueshëm. Ju duhet të na njoftoni menjëherë nëse viheni në dijeni të ndonjë përdorimi të paautorizuar të anëtarësimit tuaj në Club.
- 4.9. Pavarësisht subjektit ku e keni blerë anëtarësimin në WIZZ Discount, ju keni të drejtën të përdorni përfitimet për të gjitha fluturimet e të gjitha subjekteve Wizz Air në përputhje me kushtet e përgjithshme aktuale.
- 4.10. Përfitimet janë të vlefshme vetëm për një prenotim për fluturimin përkatës në përputhje me llojin e anëtarësisë së WIZZ Discount Club. Në një fluturim të caktuar mund të bëhet vetëm një prenotim duke përdorur përfitimet e anëtarësisë së WIZZ Discount Club. Në rast mospajtimi me dispozitën në fjalë, Wizz Air ruan të drejtën t'i anulojë rezervimet.

## 5. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

- 5.1. Të gjitha promocionet, biletat dhe ofertat e tjera të mundshme speciale të ofruara nga Wizz Air u nënshtrohen kushteve të përgjithshme që i përkasin në mënyrë specifike asaj oferte. Përveç nëse biem dakord ndryshe, përfitimet e Wizz Discount Club nuk mund të kombinohen me oferta të tjera.
- 5.2. Biletat dhe/ose shërbimet e blera duke përdorur anëtarësimin në Club nuk duhet të ofrohen për qëllime komerciale nga ana juaj apo e ndonjë pale të tretë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ankandet në internet apo platformat e tjera të bazuara në ueb.
- 5.3. Në rast ndryshimi në rezervim, duhet të siguroheni që të mbeteni pasagjer në rezervim gjatë gjithë kohës, në mënyrë që pasagjerët e tjerë të të njëjtit rezervim të mund të përfitojnë nga tarifat e Club. Nëse ju hiqeni nga rezervimi, do të veprojnë bileta normale për të gjithë pasagjerët e tjerë dhe duhet të paguhet diferenca e tarifës (diferenca e çmimit normal të biletës dhe atij të WIZZ Discount Club dhe tarifa normale e bagazhit dhe ajo e WIZZ Discount Club), përndryshe ne mund të anulojmë rezervimin.
- 5.4. Duhet të jepni të dhëna të sakta dhe të vërteta personale kur blini anëtarësim në Club dhe duhet t'i ruani këto të dhëna kur përdorni ndonjë prej përfitimeve të Club. Nëse nuk e zbatoni detyrimin e mësipërm, ne ruajmë të drejtën sipas gjykimit tonë ekskluziv, t'ua përfundojmë anëtarësimin.
- 5.5. Në ruajmë të drejtën e ndryshimit të njëanshëm të këtyre kushteve të përgjithshme në çfarëdo kohe duke i publikuar kushtet e përgjithshme të përdorimit në faqen e internetit.
- 5.6. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë dokument, për rezervimet e kryera apo shërbimet e blera në faqen tonë të internetit duke përdorur anëtarësimin në Club, do të zbatohen kushtet e përgjithshme të transportit për fluturimin e operuar nga subjekti Wizz Air.

## 6. AFATI DHE PËRFUNDIMI

- 6.1. Anëtarësimi në Club fillon kur ju blini anëtarësimin dhe na paguani tarifën e anëtarësimin.
- 6.2. Anëtarësimi është i vlefshëm për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë, duke filluar nga data e blerjes së anëtarësimin.
- 6.3. Pasi përfundimit, anulimit apo skadimit të anëtarësimin, nuk do të keni të drejta ndaj përfitimeve të Club.
- 6.4. Ne mund ta përfundojmë anëtarësimin tuaj në çdo moment përmes një njoftimi me shkrim drejtuar juve.
- 6.5. Nëse vendosni ta mbyllni anëtarësimin, vini re se tarifa vjetore e anëtarësimin nuk rimburohet, as në tërësi, as pjesërisht.

## 7. ANËTARËSIMI NË WIZZ DISCOUNT CLUB PËR MBAJTËSIT E KARTAVE TË KREDITIT ME DY MARKA

- 7.1. Mbjtësit e kartave të kreditit me dy marka kanë të drejtën e një anëtarësimi standard në WIZZ Discount Club pa paguar tarifën e anëtarësimin.
- 7.2. Anëtarësimi në WIZZ Discount Club me kartë me dy marka është i vlefshëm për 12 muaj. Anëtarësimi në WIZZ Discount Club aktivizohet pasi mbajtësi i kartës së kreditit aktivizon llogarinë e tij WIZZ në internet.
- 7.3. Anëtarësimi në WIZZ Discount Club do të zgjatet automatikisht me një vit tjetër, për aq kohë sa karta e kreditit është aktive.
- 7.4. Mbjtësit e kartave të kreditit që tashmë kanë një anëtarësim të vlefshëm në WIZZ Discount Club, do të kenë të drejtën e një anëtarësimi standard të përcaktuar në klauzolën 7.1, pas përfundimit të anëtarësimin të mëparshëm.
- 7.5. Në rast se karta e kreditit skadon ose marrëveshja e kartës së kreditit përfundohet nga banka ose nga mbajtësi i kartës së kreditit, Wizz Air ka të drejtën të përfundojë anëtarësimin në WIZZ Discount Club.
- 7.6. Për anëtarët e WIZZ Discount Club që janë mbajtës të një karte krediti, zbatohen të gjitha dispozitat e tjera të kushteve të përgjithshme aktuale në përputhje me klauzolën 7.

## 8. PËRDORIMI I TË DHËNAVE TUAJA PERSONALE

- 8.1. Duke blerë anëtarësimin në Club, ju bini dakord që Wizz Air të përpunojë të dhënat tuaja personale në përputhje me këtë deklaratë privatësie.

## 9. LIGJI DREJTUES

- 9.1. Këto kushte të përgjithshme u nënshtrohen ligjit hungarez dhe juridiksionit joekskluziv të gjykatave hungareze.